



LIGJET E RREGULLOJNË JETËN TONË



BASHKËPUNIMI, PJESËMARRJA DHE NDIHMA

MIRLIND (9), DARDAN (12), EDMIR (14), LIRIDONA (15), RABIJA (14), BLERTA (10)



Të dashur fëmijë, a keni menduar ndonjëherë se si ne mund ta ndryshojmë vendin tonë? Nëse jo, atëherë ne mund t'iu tregojmë. Për këtë arsye, ne ju ftojmë ta lexoni artikullin tonë

Përshëndetje për të gjithë juve. Më poshtë, do të keni mundësi të njoftoheni me shkrimtarët e këtij artikulli. Po fillojmë tani. Unë jam Liridona Osmani, unë kam pastruar disa herë ambientin dhe asnjëherë nuk e kam dëmtuar Muzeun apo parqet e vendit tim. Unë jam Edmir Babiçi, unë i ndihmoj shokët në detyrat e shkollës. Kurse, unë jam Dardan Xhela, unë ndihmoj prindërit e mi, pastroj ambientin, ndihmoj qytetarët e tjerë dhe i bëj detyrat e shtëpisë. Me radhë jam unë, Mirlind Xheladini. Çfarë bëj unë për të tjerët? Shpesh unë ndihmoj vëllezërit e mi për çfarëdo që ata kanë nevojë. Ndërsa, unë jam Rabije Abazi, ndihmoj rregullisht shokët dhe shoqet në detyrat e klasës. E në fund, unë jam Blerta Babiçi, ashtu si shokët e mi edhe unë kujdesem që atyre të mos iu mungoj asgjë dhe jam gjithmonë pranë nevojave të tyre. Neve na vjen mirë që u takuam me juve, të dashur fëmijë.

Por, a dëshironi të dini se çfarë mund të bëni akoma më shumë për vendin tuaj? Në këtë pjesë të artikullit dëshirojmë t'iu drejtohem lexuesve tanë të rritur, pasi që këto veprime për të cilat do të flasim ne kërkojnë që qytetarët të arrijnë moshën 18 vjeçare. Këta qytetarë mund të votojnë në zgjedhjet shtetërore, mund të nënshkruajnë peticione për çështjet të cilat i brengo-

sin ata, e gjithashtu mund të marrin pjesë në protesta, por vetëm se ata duhet të mbajnë mend që gjatë tyre nuk duhet të përdorin dhunë. Po ashtu, qytetarët mund të marshojnë për të adresuar pakënaqësitë e tyre.



Të votosh është e drejtë e secilit

Në këto mënyra, ata mund ta bëjnë zërin e tyre të dëgjohet pastër dhe fuqishëm. Ne kërkojmë nga ju që të bëheni qytetarë sa më aktiv dhe iu themi faleminderit me gjithë zemër të gjithë lexuesve të këtij artikulli, qofshin ata fëmijë apo të rritur.



Këta jemi ne, fytyrat prapa këtij artikulli

KUVENDI MENDON PËR MUA

SHKURTESA (10), ARGJENDA (10), BLERTA (14), KALTRINA (10), ERMAL (11), ALTIN (14)



Qytetarë të nderuar, a e dini se si Kuvendi mendon për ju? Këtë do ta mësoni në këtë artikull të shkruar me shumë përkushtim nga ne

Kuvendi është institucion shumë i rëndësishëm për popullin. Rëndësinë e tij mund ta vërejmë në çdo hap të jetës sonë. Kuvendi, punën e tij e realizon në mënyrë që qytetarët t'i kenë të gjitha kushtet jetësore të plotësuara. Me plotësimin e kushteve jetësore, arrihet



Kuvendi na sjell lumturi

harmonia dhe barazia mes qytetarëve. Ndikimi i Kuvendit vërehet dukshëm edhe në jetën e neve, nxënësve. Kuvendi për ne ka siguruar arsimimin dhe edukimin. Po ashtu, ka siguruar ligje të tjera mjaft efektive për ne. Një shembull i tillë është edhe ligji për shëndetësinë, i cili bazohet në disa parime themelore. Paanshmëria, trajtimi i barabartë, ofrimi i ndihmës pa interes, plotësimi i kushteve primare shëndetësore,

ndershmëria, përgjegjësia, janë disa nga parimet kyçe të këtij ligji. Kjo i bie se pa marrë parasysh gjininë, racën, fenë, prejardhjen, etj., të gjithë duhet t'i marrim shërbimet shëndetësore në mënyrë të njëjtë.

Demokracia, pra është kjo: mos bëra e as një lloj dallimi në asnjërin prej ligjeve të miratuara në Kuvend. Kuvendi ka miratuar edhe ligje për të drejtat e fëmijëve, pasi që fëmijët kanë rol të veçantë në fuqizimin e demokracisë. Këto ligje na mundësojnë që ne t'i gëzojmë të drejtat, që veçse i kemi. Prandaj, jemi shumë të lumtur dhe mirënjohës për shtetin tonë. Duke e parë rëndësinë e këtij institucioni ligjvënës, ju ftojme të gjithë juve qytetarë që ta ndihmoni punën e Kuvendit. Këtë ndihmë mund ta dhuroni duke i zbatuar ligjet e miratuara nga ky institucion. E megjithëse Kuvendi na jep kaq të mira neve qytetarëve, ne do të kujdesemi që ta ruajmë dhe ta zhvillojmë shtetin tonë paqësor.



Të lumtur që kemi deputetët si përfaqësues të popullit




Zëri im dëgjohej



Të drejtat e mia janë të mbrojtura



Ne kujdesemi për shtetin tonë



Qytetarët vendosin se kush do ta udhëheq vendin



Votimi ndikon në zhvillimin e demokracisë



Qeveria siguron paqe dhe harmoni në vend

ZGJEDHJET PERSONALE DHE ATO SHTETËRORE

BESIM (10), ERBLIN (9), ANITA (11), ADELINA (12), LEONIT (15), ARLIND (11)

Më poshtë, me juve do t'i ndajmë zgjedhjet tona profesionale që ne i kemi bërë

Të dashur bashkëqytetarë, unë jam Arlindi dhe unë kam zgjedhur që në studime të larta të studioj në Fakultetin e Mjekësisë. Shoku im Leoniti, ka zgjedhur që në të ardhmen të studioj në Fakultetin e Arteve dhe të bëhet një aktor i famshëm. Ndërsa, shoqja ime Adeli-na, dëshiron që në të ardhmen të bëhet sportiste, përkatësisht të angazhohet në sportin e pingpongut.

Besimi, Erblini dhe Anita janë ende në dyshim se cilin profesion do ta zgjedhin për të ardhmen e tyre. Por, e rëndësishme është që ne, duke u bazuar në aftësitë tona personale mund të zgjedhim se çfarë profesioni do ta ushtrojmë në të ardhmen.

Zgjedhjet tona personale të cilat i bëjmë në jetën e përditshme, na ndikojnë vetëm neve. Por, në Kosovë ekzistojnë edhe zgjedhjet, të cilat ndikojnë gjithë shtetin tonë. Është fjala për procesin zgjedhor, ku ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë.

Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale apo komunale, si dhe zgjedhjet qendrore apo parlamentare. Ne e kemi ende të freskët procesin e zgjedhjeve lokale, i cili ngjau disa ditë më parë. Kjo sepse prindërit tanë kanë dalur dhe kanë votuar për Kryetarin e Komunës sonë dhe asamblistët. Por, në një të ardhme të afërt, kur t'i mbushim 18 vjet, këtë mundësi do ta kemi



Gazetarët demokratikë

edhe ne. Pra, ne si qytetarë të rritur, do të mund të votojmë për përfaqësuesit e komunës apo për përfaqësuesit e gjithë shtetit, të cilët janë deputetët. Arsyeja pse ne duhet të presim ta arrijmë moshën 18 vjeçare është sepse atëherë do të dijmë të gjykojmë drejt. Në atë mënyrë, do të zgjedhim përfaqësuesit ideal me të gjitha vlerat më pozitive.

Ky ishte artikulli ynë, në të cilin kemi përfshirë informata për procesin zgjedhor, por kemi shkruajtur edhe për zgjedhjen e profesioneve tona për të ardhmen. Pjesëmarrja jonë në procesin zgjedhor është shumë e rëndësishme, sepse vetëm kështu vota jonë mund të sjell ndryshime pozitive.



Vota e secilit prej juve është e rëndësishme, prandaj ju ftoj të jeni edhe ju pjesë e vendimmarrjes për shtetin tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Azemi e Salihu“
Klasa: V, VI, VII, VIII & IX
Vendi: Dabishec, Prishtinë